


Deloitte.



Raporti i Transparencës 2021

Deloitte Audit Albania Shpk

31 Mars 2022



Përmbajtja

Mesazhi i drejtimit- Deloitte Audit Albania Shpk	1
Rrjeti Deloitte	2
Çfarë sjell Deloitte Audit në tregjet e kapitalit	6
Monitorimi i cilësisë së auditimit të jashtëm dhe të brendshëm	16
Pavarësia, etika, dhe informacione të tjera shpjeguese	20
Aneksë	25
Aneksi A Informacioni Financiar	26
Aneksi B Entitete të Interesit Publik	27

Mesazhi i Drejtimit-Deloitte Audit Albania Shpk

Ky raport paraqet praktikat dhe proceset, të cilat aplikohen aktualisht nga Deloitte Audit Albania Shpk, në përputhje me nenin 45 të ligjit, nr. 10091, datë 5 Mars 2009, ndryshuar sipas ligjit nr. 47/2016, datë 28 Prill 2016 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”.

Informacioni i paraqitur në këtë raport lidhet me situatën e Deloitte Audit Albania Shpk më 31 dhjetor 2021, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe.



Cilësia është marka jonë dhe shërben si themeli i profesionit tonë. Kur bëhet fjalë për vendosjen e cilësisë në vend të parë, Deloitte kryeson me krenari rrugën. Ne jemi të përkushtuar ndaj përmirësimit të vazhdueshëm në të gjitha nivelet e organizatës sonë dhe të palëkundur në përpjekjet tona për të thelluar përgjegjshmërinë në çdo hap të procesit të auditimit. Ne po dixhitalizojmë auditimin, po transformojmë mënyrën se si punojmë dhe po nxitim zhvillimin e njerëzve tanë, për të përmbushur rolin tonë për të ofruar shërbime të cilësisë së lartë të auditimit dhe dhënien e sigurisë në tregjet e kapitalit.

Pandemia e COVID-19 ka ndryshuar mënyrën se si ne punojmë, me shumë kompani që po përshtasin mënyrën si kryejnë biznes në lidhje me kufizimet në udhëtim ose kërkesat për të punuar nga shtëpia. Teknologjia dhe infrastruktura globale e Deloitte bëri të mundur një përgjigje të shpejtë ndaj ndikimeve të pandemisë dhe ne mbetemi të përkushtuar për të ruajtur standarde të larta të cilësisë në një mjedis në zhvillim të vazhdueshëm.

Një fokus shtesë si për klientët tanë ashtu edhe për palët e tyre të interesit ka qenë mbi temat mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (MSQ) - veçanërisht klima. Ndërsa konsideratat e MSQ janë ngritur në krye të axhendave të kompanive, rregullatorëve, investitorëve dhe shoqërisë në përgjithësi, Deloitte ka marrë pjesë në mënyre aktive në diskutime me qëllimin për të mbështetur përmirësimet në dobinë, besueshmërinë dhe krahasueshmërinë e shënimeve shpjeguese të MSQ. Ne presim në vijueshmëri të vazhdojmë fort dialogun mbi këtë temë me palët tona të interesit dhe politikëbërësit, ndërsa ata së bashku lundrojnë në ndikimin e temave të MSQ në shenimet shpjeguese dhe vendimmarrjen e tyre. Ndërsa lundrojmë në ndryshimet që do të vijnë, ne mbetemi të sigurt në aftësinë tonë për të mbajtur një fokus lazer të mprehtë mbi cilësinë përmes metodave, procedurave dhe masave tona të përgjegjshmërisë. Raporti i Transparencës 2021 ofron një depërtim të thellë në strukturën, qeverisjen dhe qasjen tonë që bazohet në një sistem të fortë kontrollesh të cilësisë. Ne e publikojmë këtë raport çdo vit për të ofruar informacione shpjeguese për disa kategori informacioni që lidhen me qeverisjen e korporatave dhe transparencën.

Ne jemi lider në shërbimet e auditimit dhe dhënies së sigurie me cilësi të lartë përmes angazhimit tonë për besim dhe integritet dhe do të vazhdojmë të rrisim standartin për profesionin. Ne e kuptojmë se mbajmë një përgjegjësi të madhe në punën që bëjmë për njerëzit tanë, klientët, komunitetet dhe tregjet e kapitalit dhe do të vazhdojmë të nxitim për standardet më të larta të cilësisë përmes vendimeve dhe veprimeve tona të përditshme. Faleminderit për mundësinë për të theksuar progresin tonë.

Enida Cara FCCA, AL

Drejtoreshë e Shërbime të Auditimit dhe Këshillimit të Sigurisë Financiare
Deloitte Audit Albania Shpk

Rrjeti Deloitte

Deloitte Audit Albania: struktura ligjore dhe pronësia

Deloitte Audit Albania Shpk është e lidhur me rrjetin Deloitte përmes Deloitte Central Europe Holdings Limited, një shoqëri anëtare e Deloitte Touche Tohmatsu Limited. Deloitte Central Europe, së bashku me Deloitte France, Deloitte Germany, Deloitte Luxembourg dhe Deloitte Austria janë aksionerë në Deloitte DCE GmbH ("DCE"), që është gjithashtu një shoqëri anëtare e Deloitte Touche Tohmatsu Limited. Synimi i DCE është nxitja e bashkëpunimit midis aksionerëve të saj si anëtarë të rrjetit global Deloitte. DCE nuk ofron ndonjë shërbim profesional dhe nuk angazhohet me aktivitete tregtare.

Deloitte Audit Albania Shpk është referuar përgjatë këtij raporti si "Deloitte Audit Albania". Deloitte Central Europe, si një organizatë e entiteteve të organizuara nën ombrellën e Deloitte Central Europe Holdings Limited, është referuar përgjatë këtij raporti si "Deloitte Central Europe".

Deloitte Central Europe Holdings Limited zotëron të drejta për të ofruar shërbime profesionale duke përdorur emrin "Deloitte", emër i cili përdoret nga njësitë e Deloitte brenda territorit të saj (Deloitte Central Europe), përfshirë Deloitte Audit Albania. Deloitte Audit Albania është e autorizuar të shërbejë si auditor për klientët në Shqipëri.

Deloitte Audit Albania operon si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas ligjit Shqiptar, me zyrë të regjistruar në Rr. "Faik Konica", 1010, Tiranë, Shqipëri dhe numër regjistrimi L41709002H.

Mbajtësit e kuotave janë si më poshtë:

- Olindo Shehu - 51 %
- Deloitte Central Europe Holdings Limited - 49 %


Kërkesa për licencim për pajtueshmërinë me ligjin

Deloitte Audit Albania sh.p.k. është regjistruar në regjistrin publik të ekspertëve kontabël të autorizuar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) më 31 korrik 2014 me numër license 423.

Përshkrimi i rrjetit

Rrjeti Deloitte

Rrjeti Deloitte është një rrjet global i shoqërive anëtare dhe filialeve të tyre që operojnë në më shumë se 150 shtete dhe territore në të gjithë botën. Këto shoqëri të vecanta dhe të pavarura operojnë nën një markë të përbashkët.



Deloitte Touche Tohmatsu Limited (DTTL ose Deloitte Global)

Deloitte Touche Tohmatsu Limited është një kompani private në Mbretërinë e Bashkuar me përgjegjësi të kufizuar me garanci, e inkuorporuar në Angli dhe Uells. DTTL luan një rol koordinues për firmat anëtare dhe filialet e tyre, duke kërkuar respektimin e politikave dhe protokolleve me qëllim promovimin e vazhdueshëm të një niveli të lartë të cilësisë, të sjelljes profesionale dhe shërbimit në të gjithë rrjetin Deloitte. DTTL nuk ofron shërbime profesionale ndaj klientëve, dhe as nuk drejton, menaxhon, kontrollon apo zotëron ndonjë interes në ndonjë firmë anëtare apo entitete të lidhura me ndonjë firmë anëtare.

"Deloitte" është brandi nën të cilën afërsisht 345,000 profesionistë të përkushtuar në firma të pavarura në të gjithë botën bashkëpunojnë për të ofruar auditim, konsulencë, këshillim financiar, këshillim risku, shërbim taksash dhe shërbime të ngjashme ndaj klientëve të zgjedhur. Këto firma janë anëtare të DTTL. DTTL, këto firma anëtare dhe secila prej entiteteve të lidhura respektive, formojnë "organizatën Deloitte". Çdo firmë anëtare e DTTL dhe / ose entitetet e lidhura ofrojnë shërbime në zona të veçanta gjeografike dhe i nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve profesionale të një vendi të caktuar ose vendeve në të cilat operojnë. Çdo firmë anëtare e DTTL është strukturuar në përputhje me ligjet, rregulloret, praktikën zakonore dhe faktorë të tjerë, dhe mund të sigurojë ofrimin e shërbimeve profesionale në territoret e saj përkatëse përmes njësive të lidhura. Jo çdo firmë anëtare e DTTL ose entitetet e lidhura ofrojnë të gjitha shërbimet dhe disa shërbime mund të mos jenë të disponueshme për të atestuar klientët sipas normave dhe rregulloreve të kontabilitetit publik. DTTL, dhe çdo firmë anëtare e DTTL si dhe secila prej entiteteve të lidhura, janë juridikisht të ndara dhe të pavarura, nuk mund të detyrojnë njëra-tjetrën në lidhje me palët e treta. DTTL dhe secila firmë anëtare e DTTL, dhe entitetet përkatëse të tyre, janë përgjegjëse vetëm për veprimet dhe mosveprimet e tyre, dhe jo ato të njëri-tjetrit. Organizata Deloitte është një rrjet global i firmave të pavarura dhe jo një partneritet ose një firmë e vetme. DTTL nuk ofron shërbime për klientët.

Deloitte Audit Albania: qeverisja – lidershipi në veprim

Deloitte Audit Albania operon si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas ligjit Shqiptar, me zyrë të regjistruar në Rr. “Faik Konica”, 1010, Tiranë, Shqipëri dhe numër regjistrimi L41709002H.

Bordi i Drejtuesve të Deloitte Audit Albania është përgjegjës për qeverisjen dhe mbikëqyrjen e praktikës së Auditimit dhe Këshillimit të sigurisë financiare. Përgjegjësitë specifike përfshijnë aprovimin e strategjisë lokale të biznesit për auditimin dhe sigurinë financiare, aprovimin e aspekteve financiare të planeve të biznesit vendor. Bordi i Drejtuesve asistohet nga ekipe të specializuara që këshillojnë për çështje specifike dhe / ose implementojnë politika.

Më poshtë paraqiten anëtarët e Bordit Drejtues të Deloitte Audit Albania, të emëruar nga mbledhja e aksionerëve, dhe nga Audituesit Ligjor të Autorizuar prej katër vitesh që nga data e emërimit:

Deloitte Audit Albania – Bordi i Drejtuesve

Olindo Shehu – Administrator

Enida Cara – Administrator

Gregory Paul Rossouw - Administrator

Partnerët dhe Drejtuesit e mësipërm veprojnë si administratorë të Deloitte Audit Albania, në përputhje me statutin e shoqërisë sipas ligjit nr. 9901 datë 14 Prill 2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Deloitte Audit Albania zotëron 49 punonjës profesionistë më 31 Dhjetor 2021.

Në të gjitha aktivitetet e tyre, drejtuesit e lartë të Deloitte Audit Albania janë përgjegjës për objektivin e tejkalimit të kualitetit standard të auditimit, duke përfshirë pajtueshmërinë me standardet profesionale të zbatueshme dhe kërkesat rregullatore. Strategjia e Deloitte Audit Albania është zhvilluar në përputhje me orientimin e përgjithshëm strategjik të vendosur për rrjetin Deloitte.

Drejtuesit e Deloitte Audit Albania marrin pjesë në grupe të rrjetit Deloitte që përcaktojnë dhe monitorojnë standardet e cilësisë, dhe prej të cilave burojnë një sërë iniciativash të cilësisë së auditimit.

Qëllimi dhe angazhimi ynë: të nxitim besim dhe konfidencë

Në Deloitte Audit Albania, qëllimi ynë është të lëmë një impakt që ka rëndësi. Për Auditimin dhe Sigurinë financiare, kjo nënkupton fokusin tonë në zhvillimin e auditimeve të pavarura me cilësi të lartë dhe nxitjen e konfidencës dhe besimit në tregjet e kapitalit përmes shërbimeve që ne ofrojmë. Kjo kërkon që ne, në mënyrë të vazhdueshme, të zhvillojmë aftësitë për të suportuar kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë dhe të japim kontribute me rëndësi në modelimin e së ardhmes së profesionit të audituesit.



Çfarë sjell Deloitte Audit në tregjet e kapitalit

Transformimi i Auditimit dhe Sigurisë Financiare

Të qënurit një profesion i përshtatshëm i së ardhmes dhe të ruajturit e një praktike të qëndrueshme që zhvillohet me ritmin e ndryshimit në teknologji dhe shoqëri është mjaft kritike. Iniciativa e Transformimit të Deloitte Audit & Siguri Financiare, ka pikërisht këtë qëllim, që aktualisht po zhvillohet dhe është implementuar në rrjetin Deloitte, duke përfshirë Deloitte Audit Albania.

Transformimi i Auditimit dhe Sigurisë Financiare është një ndryshim i rëndësishëm në të gjithë rrjetin në mënyrën si punojnë profesionistët e Deloitte dhe përfshin:

Mënyra Deloitte: standartizimi i proceseve të auditimit të mbështetura nga teknologjia e përshtatshme	Monitorim i cilësisë së auditimit në kohë reale
Fuqizimi i modelit talent, që përfshin të mësuarit, shpërblimet, qendrat e përsosmërisë dhe qendrat e shpërndarjes	Implementimi i shpejtë i instrumenteve dhe teknologjive për t'iu përgjigjur ndryshimeve rrethore

Njesite e audituara prej Deloitte Audit Albania

Si pjesë e angazhimit të Deloitte Audit Albania Audit & Assurance për të mbështetur tregjet e kapitalit, Deloitte Audit Albania është fokusuar në subjektet audituese ku i shërben interesit publik dhe ku Deloitte Audit Albania ka aftësitë për të kryer një auditim cilësor me objektivitet dhe në përputhje me kërkesat e zbatueshme, standardet etike dhe profesionale.

Deloitte Audit Albania ka politika dhe procedura të detajuara për aprovimin e klientëve dhe angazhimeve të ardhshme dhe vlerësimin e riskut të angazhimit. Këto politika dhe procedura janë hartuar me objektivitet që Deloitte Audit Albania pranon vetëm angazhimet për të cilat:

- Është në gjendje të kryejë angazhimin dhe ka aftësitë, duke përfshirë kohën dhe burimet, për ta bërë këtë.
- Mund të pajtohet me të gjitha kërkesat përkatëse etike dhe standardet profesionale, duke përfshirë vlerësimet dhe konsideratat e pavarësisë dhe të konflikteve të interesit.
- Ka konsideruar integritetin e ekipit të menaxhimit të klientit potencial.

Inovacioni i Auditit

Me mënyrën Deloitte, Deloitte po sjell risi në thelbin e mënyrës se si ne auditojmë: me automatizimin që përmirëson detyrat rutinë, analitikat që japin një perspektivë më të thelluar dhe më të kuptueshme të të dhënave, dhe inteligjencën artificiale që përmirëson zbulimin njerëzor dhe zgjidhjen e problemeve. Si rezultat, klientët përjetojnë një përvojë më pak të rënduar, me më shumë transparencë dhe njohuri më të thelluara.

Inovacioni është një pritshmëri në mjedisin e sotëm të biznesit që ndryshon me shpejtësi, dhe kjo pritshmëri vlen edhe për profesionin e audituesit. Mjedi i sotëm kompleks i biznesit kërkon që auditimi të jetë dinamik, shumëdimensional dhe informues. Ka kërkesë për informacion në kohë reale, të rëndësishëm, dhe klientët presin që auditimet të zhvillohen ndërsa përtërijnë bizneset dhe proceset e tyre. Ndërsa procedurat tradicionale ende kanë vendin e tyre në auditim, audituesit e Deloitte Audit Albania po përmirësojnë procedurat duke përdorur më shumë analitika bazuar në teknologji, Inteligjencën Artificiale (AI), teknologjitë kognitive dhe bazuar në 'cloud', etj. Kjo është pjesërisht për shkak të rritjes së automatizimit dhe efektivitetit që instrumentet analitike të të dhënave dhe instrumente të tjera mund të sigurojnë, por edhe nevoja që Deloitte Audit Albania ka për të qëndruar në frontin e parë të përparimeve teknologjike të përdorura nga entitetet që ne auditojmë.

Inovacioni është një pjesë integrale e të gjithë procesit të auditimit.

Deloitte është përkushtuar drejt investimeve të vazhdueshme në teknologjitë e fundit dhe drejt larmisë së të menduarit që mundëson një cilësi të përmirësuar, njohuri dhe vlere për klientët tanë dhe tregjet. Kjo përfshin Illumia, platformën tonë të analizave, si dhe një komplet të integruar të instrumenteve të inovacionit të gjitha të lidhura me re-në. Ne po zhvillojmë gjithashtu platformën e gjeneratës së re të performimit të auditimit bazuar në 'cloud' - Omnia - përveç Levvia, një zgjidhje për të mbështetur auditimet tona shumë të vogla.

Sëmundja Coronavirus 2019 (COVID-19)

Prioriteti më i lartë i Deloitte Audit Albania është siguria dhe mirëqenia e profesionistëve të tij. Ndërsa shpaloset ndikimi i COVID-19, investitorët dhe palët e interesuara shohin drejt audituesve më shumë se kurrë për të dhënë një opinion të pavarur mbi pasqyrat financiare të kompanive. Deloitte mbetet kompani e përkushtuar për këtë rol kritik dhe për kryerjen e auditimeve me cilësinë më të lartë.

Menaxhmenti i Deloitte Audit Albania dhe audituesit ndikohen nga kufizimet në udhëtime dhe kërkesat për të qëndruar në shtëpi. Me kufizime të udhëtimit që ndikojnë personelin dhe audituesit e njësive ekonomike, kompanitë mund të marrin informacione në mënyra të reja ose të ndryshme. Për më tepër, menaxhmenti i Deloitte Audit Albania është përballur me një pasiguri të konsiderueshme në dhënien e gjykimeve për të projektuar rezultatet e ardhshme operationale, flukset e parasë, vijëmbësinë, dhe zhvillimin e analizës së vlerësimit, etj. Procesi i raportimit financiar ka të ngjarë të kërkojë analizë të kujdesshme dhe konsiderata të mëtejshme të ndikimit nga menaxhimi dhe audituesit duke pasur parasysh mjedisin aktual.

Të gjithë palët e interesuara të ekosistemit të raportimit financiar duhet të ushtrojnë gjykim domethënës në këtë mjedis të paprecedent dhe të pasigurt - qeveritë, kur projektojnë kohëzgjatjen e lockdoën-it; bankierët, kur vendosin nëse një kredi mund të shlyhet plotësisht; menaxhimi, kur vlerëson nëse një kompani mund të operojë në vijëmbësi dhe komitetet e auditimit që sigurojnë mbikëqyrjen e menaxhimit; audituesit, kur vlerësojnë këto gjykime; dhe investitorët, kur analizojnë informacionin financiar të disponueshëm në dritën e këtyre pasigurive të paprecedenta.

Megjithëse kornizat ekzistuese të kontabilitetit kanë provizione për pasiguritë, është e rëndësishme që përdoruesit e pasqyrave financiare dhe rregullatorët të presin një shkallë më të lartë të paqëndrueshmërisë së tregut dhe ekonomisë në të ardhmen e afërt.

Deloitte mirëpret deklaratat dhe udhëzimet publike të lëshuara nga rregullatorët që njohin pasiguritë aktuale dhe theksojnë rëndësinë e paraqitjes së informacioneve për korporatat me cilësi të lartë, me perspektive progresive. E rëndësishmja është që, disa rregullatorë kanë përcjellë idenë se përpjekjet me mirëbesim për t'u siguruar investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut informacione të kornizuara të orientuara drejt së ardhmes, nuk do të mendohen për së dyti. Deloitte kërkon të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me fushat që paraqesin sfida dhe kërkojnë më shumë kontroll, gjykim specifik sipas kontekstit, dhe rritjen e skepticizmit dhe

dokumentacionit. Ka përfitime për publikun për transparencë më të lartë nga aktorë të ndryshëm të ekosistemit të raportimit financiar, që shtojnë ndërgjegjësimin për këto çështje. Kjo përfshin qartësimin mbi përgjegjësitë e menaxhmentit, komiteteteve të auditimit, kompanive, audituesve, rregullatorëve dhe aktorëve të tjerë.

Objektivat strategjikë gjithëpërfshirës të Deloitte Audit Albania janë të bazuara në parime dhe mbeten të pandryshuara (p.sh. investime në cilësi, njerëz dhe teknologji), megjithatë, disa procese të lidhura janë modifikuar ose prioritizuar për të faktorizuar ndryshime të paparashikuara për shkak të pandemisë. Firmave Deloitte iu kërkua të zbatonin proceset e monitorimit dhe konsultimit për të ruajtur standarde të larta të cilësisë dhe për të përforcuar fushat kryesore të fokusit të ndikuar nga implikimet e COVID-19.

Deloitte Audit Albania ka qenë e fokusuar në vendosjen e theksit të nevojshëm për periudhën sfiduese historike që pasoi. Nga perspektiva e rrezikut të auditimit, mjediset e qarkullueshme ekonomike dhe shëndetësore globalisht vazhdojnë të ushtrojnë presion mbi rrezikun e mashtrimit, zhvlerësimit të aseteve dhe parimit të vazhdimësisë, në industri të caktuara. Sfidat operationale në disa industri mund të shfaqen në sfida të raportimit financiar, ndërsa industritë e tjera mund të përfitojnë nga mjedisi aktual.

Standardet profesionale, politikat dhe udhëzimet e Deloitte Audit Albania, rrjetet e forta të konsulencës dhe specialistëve, si dhe kujdesi i palëkundur vazhdojnë të jenë baza për ekzekutimin e auditimeve me cilësi të lartë nga Deloitte Audit Albania. Teknologjia dhe infrastruktura e Deloitte Audit Albania lejuan një reagim të shkathët dhe të shpejtë ndaj ndikimeve të ndryshme të pandemisë COVID-19. Deloitte Audit Albania u përgatit për situata të ndryshme të paparashikuara për të mbështetur nevojat në ndryshim dhe për të mbështetur profesionistët gjatë periudhave kur atyre u është kërkuar të punojnë në distancë. Deloitte Audit Albania vazhdon të përdorë Deloitte Audit & Assurance Technical Delivery Resource Center – një vend qendror për të gjithë profesionistët e Deloitte Audit Albania për të aksesuar burimet dhe udhëzimet e auditimit të lidhura me COVID-19 të përshtatshme globalisht dhe të adaptueshme në nivel lokal. Këto përgjigje na kanë lejuar të vazhdojmë përfundimin e zbatimit e qasjes së auditimit të Deloitte Audit Albania gjatë gjithë pandemisë.

Deloitte ka udhëhequr gjithashtu iniciativat globale për të kuptuar implikimet e punës virtuale për profesionistët, për t'u ofruar atyre mbështetje për të përmirësuar bashkëpunimin në ekip dhe për të shqyrtuar mënyra të reja të se punuarit në një mjedis të pavarur. Pavarësisht

mjedisit virtual të punës, te mësuarit iu percollen me sukses profesionistëve të Deloitte Audit Albania përmes programeve virtuale dhe ne po e përdorim këtë përvojë për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm.

Transformimi i ekzekutimit të auditimit në një mjedis pune gjithnjë e më dinamik ka bërë që Deloitte Audit Albania t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave që ndryshojnë me shpejtësi të peizazhit të talenteve. Ndërsa

Deloitte Audit Albania po organizon rikthimin në vendin e punës në disa shtete, ajo po sfidon metodat e saj historike të punës dhe po konsideron një mjedis pune hibrid.

Ne vijim, Deloitte Audit Albania do të vazhdojë të përqendrojë përpjekjet e saj dhe të sigurojë një përvojë të qëndrueshme auditimi në një mënyrë që përfaqon pritshmëritë në zhvillim të klientëve dhe profesionistëve.

Modeli multidisiplinar (MMD)

MMD është një kontributor i rëndësishëm në auditimet me cilësi të lartë. Audituesit gjithnjë e më shumë përdorin punën e specialistëve në një numër fushash, përfshirë asistimin e tyre në vlerësimin e parametrave kontabël dhe në matjen e vlerës së drejtë kur auditohen pasqyrat financiare të kompanive që janë gjithnjë e më komplekse si rezultat i COVID-19. Më tej, ndërsa përdorimi i të dhënave të mëdha bëhet gjithnjë e më i përhapur në një linjë me përparimet e tjera dixhitale, kërkesa për analistë të dhënash dhe specialistë të IT do të rritet në përputhje me rrethanat. Përfitimet e MDM janë:

- Mundëson zhvillimin e njohurive mbi industrinë përmes lenteve të shumëfishta, gjë që rrit kuptueshmërinë e audituesve për risqet e biznesit në lidhje me kryerjen e auditimeve.
- Praktika e auditimit ka akses të menjëhershëm në burime dhe ekspertizë të specializuar në linjat e tjera të biznesit. Ajo promovon cilësinë e auditimit teksa audituesit mund të përfitojnë nga ekspertiza e profesionistëve këshillues, të cilët janë të aftë në tema që mund të mos jenë të njohura për audituesit.
- Një organizatë e larmishme ndihmon në tërheqjen dhe ruajtjen e talenteve kryesore.
- Kapitali intelektual është i disponueshëm brenda rrjetit për të përtërirë proceset e auditimit, teknologjitë, etj.
- Pjesë të ndryshme të biznesit tonë rriten me ritme të ndryshme gjatë periudhave të ndryshme kohore në tregje të ndryshme. MMD siguron një mbrojtje kundër paqëndrueshmërisë së tregut që është e rëndësishme për qëndrueshmërinë afatgjatë të rrjetit dhe bën të mundur investime të konsiderueshme në cilësinë e auditimit dhe në inovacion, madje edhe në kohë presionesh financiare mbi biznesin e auditimit.

Reagimi i Deloitte ndaj COVID-19 demonstroi si elasticitet në përcaktimin e cilësisë së auditimit ashtu edhe interesit publik si parësor, mbështetur më tej nga përfitimet e konsiderueshme të MMD. Çdo biznes i Deloitte Audit Albania pa auditim ka një interes të përbashkët dhe të veçantë në mbështetjen e iniciativave të cilësisë së auditimit dhe strategjisë së Deloitte Audit Albania për të ofruar shërbime me cilësi të lartë dhe të qëndrueshme globalisht për klientët.

Zhvillimi profesional dhe menaxhimi i performancës

Kultura Deloitte dhe dizenjimi i programeve tona të të nxënit i vendosin njerëzit tanë në front të parë. Profesionistët e Deloitte janë teknikisht të aftë me nivele të larta të etikës, integritetit, skepticizmit profesional dhe objektivitetit, dhe vazhdimisht po zhvillojnë aftësitë dhe përvojën e tyre.

Deloitte është përkushtuar në ofrimin e një përvojë të pakrahasueshme talentesh, duke zhvilluar profesionistët tanë dhe duke çuar më tej karrierën e tyre përmes krijimit të një mjedisi të të mësuari gjatë gjithë jetës. Ne jemi duke avancuar edukimin e auditimit, aftësitë dhe opsionet fleksibël të karrierës që tërheqin audituesit e ardhshëm.

Profesionistët e Deloitte kanë formime diverse, njohuri dhe aftësi të ndryshme që përmirësojnë aftësinë tonë si një organizatë në kryerjen e auditimeve me cilësinë më të lartë.

Për më tepër, disiplina operationale, menaxhimi efektiv i biznesit tonë dhe zhvillimi i një qasje të veçantë për të bërë auditime sipas Mënyrës Deloitte, sigurojnë bazën për angazhimin tonë për të sjellë qëndrueshmëri në auditimet tona.

Deloitte Audit Albania po drejton një biznes të qëndrueshëm auditimi dhe

sigurie që njeh dhe shpërblen njerëzit e tij dhe investimet e vazhdueshme në të ardhmen e tyre.



Nismat e të mësuarit dhe zhvillimit

Qasja e transformuar e Deloitte në ofrimin e auditimit po ndryshon përvojën e auditimit për profesionistët tanë. Ekipet e auditimit fuqizohen nga instrumente dhe teknologji më të përparuara dhe nga përdorimi më i gjerë i analitikave të të dhënave brenda një rrjedhe pune të orientuar për të ekzekutuar ciklin e auditimit të plotë. Për profesionistët tanë, kjo do të thotë të përqendrohemi në mënyrën se si angazhimi planifikohet, ekzekutohet dhe menaxhohet në mënyrë konsistente në të gjithë globin duke përdorur teknika dhe aftësi me perspektivë nga e ardhmja. Kjo qasje gjithashtu ofron mundësi për të përmirësuar aftësitë e tyre teknike dhe profesionale. Për shembull, aftësitë e mëposhtme bëhen më të rëndësishme - analitikë e përmirësuar e të dhënave, menaxhimi i projektit, mendimi kritik, komunikimi, gjykimi i zgjeruar profesional dhe zbatimi i parimeve të kontabilitetit dhe auditimit për të punuar në mënyrë më efektive dhe për të patur angazhime me kualitet më të lartë.

Jo vetëm që ofrojmë vlerë në më shumë fusha, por ndërsa përmirësojmë aftësitë, ne ndërtojmë besim më të madh dhe bëhemi vlerësues gjithnjë e më të mirë të riskut.

Deloitte ka bërë investime thelbësore në talent dhe strategjitë e të mësuarit dhe ka transformuar kurrikulën e auditimit teknik për të ndërtuar aftësitë e rifreskuara dhe ekselencës e kërkuar nga niveli:

- Në thelb, ne kemi një kurrikulë të vetme, të detyrueshme të të mësuarit teknik të auditimit për audituesit, që targeton personat sipas nivelit, duke përdorur një përzierje dinamike të kryesuar nga instruktorë, kurse dixhitale sipas kërkesës dhe aktivitete në vendin e punës.
- Të gjithë profesionistëve të shërbimit të klientëve u kërkohet të kryejnë të paktën 20 orë arsimim të vazhdueshëm profesional (CPE) çdo vit dhe të paktën 120 orë çdo tre vjet, përmes programeve të strukturuar, formale, të tilla si kurse të brendshme ose të jashtme, seminare ose mësim elektronik duke mbuluar të gjitha fushat e modelit të kompetencës (p.sh., kompetencat e përbashkëta, kompetencat teknike specifike të funksionit dhe kompetencat në fushat e specializimit).
- Të gjithë profesionistët e shërbimit të klientit kanë përcaktuar qartë pritshmëritë e roleve dhe Standardet tona të Talentit përshkruajnë aftësitë që kërkohen nga praktikuesit në secilin nivel.

Deloitte gjithashtu ka krijuar mundësi specifike të të mësuarit për specialistët që punojnë në angazhimet e auditimit për të mbështetur njohuritë dhe kuptueshmërinë e tyre të procesit të auditimit. Menaxhimi i zgjeruar i projektit, një aftësi kryesore për ekzekutimin e angazhimeve të auditimit, është përfshirë në programet vjetore të zhvillimit, të cilat ofrojnë një ndërthurje të zhvillimit të të mësuarit të aftësive teknike dhe aftësive të buta. Qëllimi i programit të zhvillimit profesional Deloitte Audit Albania është të ndihmojë partnerët dhe praktikuesit të mbajnë dhe të përmirësojnë kompetencën e tyre profesionale dhe të sigurojnë qëndrueshmërinë e ekzekutimit të auditit. Për të suplementuar zhvillimin në mjedis pune, Deloitte Audit Albania ofron programe zyrtare të zhvillimit profesional të vazhdueshëm në fushat përkatëse në përputhje me Kurrikulën e Auditimit dhe Sigurimit Financiar të Deloitte Audit Albania.

Përmes një sistemi të automatizuar të monitorimit, është e mundur të kontrollohet statusi i kurseve të brendshme dhe të jashtme të ndjekura nga një auditues individual. Edukimi i vazhdueshëm është gjithashtu një faktor i marrë në konsideratë për vlerësimin vjetor të stafit të auditimit dhe vlerësimin e potencialit të tyre të rritjes..

Universiteti Deloitte

Deloitte kultivon në mënyrë aktive njohuritë dhe aftësitë kolektive të profesionistëve globalisht përmes investimeve të vazhdueshme në Universitetet Deloitte (DU). Këto janë qendrat më të fundit të të mësuarit dhe zhvillimit të përqendruar në kulturën Deloitte, dhe të rrënjosura në parimet e udhëheqjes në një mjedis të mësuarit shumë gjithëpërfshirës.

Deloitte.
University

Kompensimi i Partnerit

Kryerja e auditimeve të cilësisë së lartë pritet nga të gjithë profesionistët e Deloitte dhe është e zbatueshme në të gjithë rrjetin e tij. Cilësia e auditimit njihet përmes programeve të shpërblimit dhe ndërtohet sipas standardeve të performancës në çdo nivel, kundrejt të cilave maten vlerësimet në total të profesionistëve.

Partnerët e Deloitte Audit Albania vlerësohen çdo vit, dhe në varësi të rezultatit të vlerësimit, shpërblimi i partnerëve mund të rritet ose të ulet. Specifikisht, për vlerësimet e partnerëve merren parasysh faktorët e mëposhtëm: cilësia, ekspertiza, integriteti, profesionalizmi, sipërmarrja, pavarësia dhe pajtueshmëria.

Fokusi prioritar i Deloitte Audit Albania në cilësinë e auditimit

